



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University	
Date stamping	30.07.2024
Serial number	051/1571



## Erasmus+

---

### Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte e Universitetit Publik “Kadri Zeka”, në Gjilan,

**shpall këtë:**

**Thirrje për aplikime për shkëmbim të stafit  
në Universitetin “Kastamonu University” në  
Kastamonu, Turqi**

Universiteti Publik “Kadri Zeka”, është pjesë e projektit KA171 ICM, 2022-2027, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Kastamonu University, nga Turqia.

Programi Erasmus + KA171 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i stafit (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të Kastamonu University nga Turqia dhe Universitetit “Kadri Zeka”, në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti “Kadri Zeka” – Gjilan për studim dhe trajnim / veprimitari të lëvizjes në fusha të ndryshme, ku në këtë thirrje do të ketë mundësi që një(1) staf i UKZ-së të realizojnë mobilitetin në Universitetin e Kastamonus.

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti sipas Distance Caluculator të Erasmus +:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

Granti i udhëtimit do të paguhet pas lëvizjes nga projekti dhe mbulohet nga Universiteti pritës.

#### Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.



## APLIKIMI DHE PËRZGJEDHJA

Kriteret për aplikim për stafit janë:

Të jeni mësimdhënës i rregullt në UKZ apo në rast të stafit administrativ të keni kontratën valide të punës në UKZ.

### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kontrata e punës(që dëshmon se jeni stafi i rregullt i UKZ-së, apo staf administrativ);
- CV në Gjuhën Angleze(ku janë të përmendura edhe punimet shkencore, si dhe të arriturat e tjera dhe përvoja e punës);
- Kopje e pasaportës(faqja që përbën emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale) ose letërnjoftimit;
- Një letër motivimi(në gjuhën angleze);
- Kërkohet njohuri e gjuhës angleze e dëshmuar;

Përzgjedhja bëhet:

- Në bazë të fushës së përafërt të ligjërimit me fushat e ofruara nga Universiteti pritës 50% dhe fusha juaj e veprimit në UKZ;
- Gjuha e huaj 50%

### PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar(kopje fizike ose online në [internationaloffice@uni-gjilan.net](mailto:internationaloffice@uni-gjilan.net)), prej datave 30.07.2024 deri 09.08.2024;
2. Të gjithë aplikantët duhet të janë në gjendje të sigurojnë dëshminë/ certifikatën e gjuhës angleze C1 të njohura ndërkombëtarisht si the TOEFL, the IELTS;
3. Aplikantët të cilët ishin pjesë e mobilitetit në të kaluarën nuk kanë përparësi ndaj aplikantëve të cilët aplikojnë për herë të parë në thirrje të llojit të tillë(ata do të kuotohen me pikë negative nga komisioni);
4. Rezultatet e aplikimit do të shpallen në [www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.

Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka  
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar/dhe Projekte